



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
**DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

---

Nr. 770 Prot Tiranë, me 19.12.2013

**Lënda:** Dërgohet rekomandim për sistemimin e kablove në lagjen “Iliria”

**Drejtuar:** CEZ Shpërndarje Sh.a

**SHKODËR**

**I Nderuar Z. Drejtor!**


Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin si dhe bazuar në kompetencën që i jepet në bazë të nenit 32, pika 1, shkronja “f”, të këtij ligji, për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin, parashtron sa më poshtë vijon:

Në kuadër të projektit me titull “Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar”, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) në partneritet me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi , mbështetur financiarisht nga Zyra e Kooperacionit Zviceran në Tiranë, po zhvillohen Ditë të Hapura dhe takime me OJF-të në qytete të ndryshme të Shqipërisë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe zbatimin e tij të plotë nga gjithë aktorët e përcaktuar në ligj.

Në kuadër të këtij projekti, u zhvillua edhe një Ditë e Hapur në qytetin e Shkodrës, nga ku u raportuan problematika të shumta të qytetarëve lidhur me trajtimin e pabarabartë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe KShH kanë konstatuar, nëpërmjet një numri të lartë ankesash të komunitetit egjiptian, banues në lagjen “Iliria”, si një ndër problematikat më të rëndësishme amortizimin e kablove të energjisë elektrike.

Dëshirojmë të sjellim në vëmendjen Tuaj se komuniteti rom/egjiptian është një komunitet vulnerabël në shoqërinë tonë, i cili duhet të gëzojë në mënyrë të barabartë me të tjerët mundësinë për të marrë ose për të përfituar nga të mirat apo shërbimet.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Sa më lart, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ku parashikohen shkaqet e diskriminimit dhe nga ku komuniteti rom, si një nga grupet vulnerabel, hyn në objektin e këtij ligji, nenit 20 që ndalon diskriminimin në fushën e të mirave dhe shërbimeve dhe nenit 11 të këtij ligji që parashikon marrjen e masave të përkohshme dhe të veçantë që synojnë përshejtimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, si dhe me qëllim garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit:

### REKOMANDOJME:

1. CEZ Shpërndarje sh.a, Shkodër, të ketë përparësi marrjen e masave për sistemimin e kablllove në lagjen “Iliria”.
2. Marrjen e veprimeve pozitive të cilat synojnë ushtrimin në të mënyrë të barabartë me të tjerët të të drejtave dhe lirive themelore, në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve.

Lidhur me masat që do të ndërmarrë organi administrativ për zbatimin e këtij rekomandimi, lutemi të na vini në dijeni brenda një afati të arsyeshëm.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,



Konceptoi: Blerina Pirani  
Datë: 12.12.2013



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Nr. 21 Prot

Shkoder, më 07/01/2014

**Drejtuar : Zj.Irma Baraku**  
**Komisioneri per mbrojtjen nga Diskriminimi**  
**Tirane**

**Subjekti: Kthim pergjigje**

Ne pergjigje te shkreses me Nr.770 Prot,dt:19.12.2013,me subjekt "Dergohet rekomandim per sistemimin e kabllove ne lagjen"Iliria" ju informoj se jemi ne sherbim te te gjithe konsumatoreve per furnizimin sa me cilesor me energji elektrike.Lagjia Iliria furnizohet nga kabina elektrike Vasil Shanto e cila eshte jashte kushteve teknike,per te cilen kemi informuar dhe instancat e tjera.Per sistemimin e kesaj zone duhet nje plan investimi si dhe vendosja e nje kabine te re per te cilen kemi bere kerkesen per "Miratim sheshi, ndertim kabine" prane Bashkise Shkoder,jemi ne pritje te ketij miratimi per vazhdimin e punimeve.

Faleminderit per bashkepunimin!

**Z.Gledis Çeliku**  
**Drejtori i Drejtorisë Rajonale Shkodër**



CEZ SHPËRNDARJE Sh.a

Shoqëri në Administrim të Përkohshëm